



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
KUÇOVË

Nr. 1607 Prot.

Kuçovë, më 2.5. 2024

V E N D I M

Nr. 26, datë 25/04 2024

Për

**“Miratimin e hartimit për projektet e ndërtimit të banesave për familjet, Ymer Ramazani, Artan Ramazani dhe Fatmir Bregaj , të prekura nga rënia e zjarrit si dhe pajisjen me leje ndërtimi me procedurë të përshpejtuar.**

Këshilli Bashkiak, pasi u njohë me materialin e paraqitur nga Komisioni i Emergjencave Civile, mbështetur në ligjin 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligji nr.45/2019 “ Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr.887 datë 24.12.2019 “ Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ ndërtimit, në rastet e fatkeqësive natyrore”, si dhe V.K.M nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmes shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

VENDOSI:

1. Miratimin e hartimit të projektit për familjet, Ymer Ramazani, Artan Ramazani dhe Fatmir Bregaj , të prekura nga rënia e zjarri.
2. Pajisjen me leje zhvillimi , leje ndërtimi për këto familje dhe ndjekjen me procedurë të përshpejtuar për shqyrtimin dhe miratimin e lejes së ndërtimit deri në pajisjen me certifikatë përdorimi

3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit të Territorit dhe Kryetari i Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn ne fuqi 10 ditë pas shpalljes

Ky vendim u miratua me 17 vota Pro, — vota kundër dhe — vota abstenim.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Aleksandër Ziu**

